



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.,

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM
Nr. 174, datë 26.04.2021

MBI
REFUZIMIN E KËRKESËS SË KANDIDATES ZNJ. {...}, PËR PËRJASHTIMIN E
RELATORIT DHE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË ZHVILLIMIT TË
KARRIERËS, NGA PROCEDURAT PËR TË CILAT AJO KA KANDIDUAR PËR
NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur më datë 24.04.2021, pasi shqyrtoi kërkesën e znj. {...}, kandidate për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, në proces verifikimi të plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit,

VËREN:

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar kërkesa e znj. {...} gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe njëkohësisht kandidate për disa prej procedurave të shpalluara nga KLGJ për ngritje në detyrë pranë Gjykatës së Lartë. Kërkesa e ardhur fillimisht në rrugë elektronike, më datë 22.04.2021, është rregjistruar me aktin nr. 1589/4 datë 23.04.2021.
2. Në kërkesën e saj znj. {...}, nisur nga kandidimi i saj në tre pozicione të hapura nga KLGJ për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, si dhe nga komunikimi që ka pasur me relatoren e caktuar nga KLGJ për verifikimin e kushteve dhe kritereve të kandidimit të saj, ka kërkuar:
 1. *Përfundimin e Relatores Marçela Shehu dhe dy antarët e Komisioni të Karrierës Z. Alban Toro, dhe Z. Ilir Toska, nga shqyrtimi i kësaj procedurë dhe i çdo vendimarrjeje të ardhshme mbi kërkesat e mia për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.*
 2. *Shqyrtimin e kësaj kërkesë së bashku me kundërshtimet e mia mbi gjetjen e njoftuar nga Komisioni i Karrierës, më datë 12 prill 2021, të cilat do të paraqiten brenda datës 30 prill 2021.*
 3. *Të drejtën për tu dëgjuar verbalisht nga KLGJ-ja në lidhje me këtë kërkesë timen.*
3. Në arsyetimin që bën në kërkesë lidhur me përjashtimin e relatores dhe të anëtarëve të tjerë të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, pasi prezanton shkaqet dhe bazën ligjore mbi të cilën bazohet kërkesa për përjashtim, në mënyrë të përmbledhur pretendon se:

- a. *Relatorja në këtë çështje, ka inicuar me iniciativën e saj, jashtë kompetencës së përcaktuar në KPAAdministrative, në kundërshtim me parashikimet e nenit 113, 114, 42/1 dhe 41/1 dhe/3/a një procedurë administrative për rishikimin e vendimeve Nr. 213, datë 18.06.2020 dhe Nr. 387, datë 07.10.2020, të KLGJ-së. Justifikimi substancial, ai i shkarkimit nga KPK-ja për kriterin e pasurisë dhe të figurës, bie në kundërshtim me procedurën e parashikuar edhe nga Vendimi 75, datë 23.06.2019, Kreu IX, për verifikimin e këtyre kriterëve, në kundërshtim me ç'ka vendosur KLGJ-ja në pikën "2" të Vendimit Nr. 213, datë 18.06.2020 dhe Nr. 387, datë 07.10.2020.*
 - b. *Megjithë, pyetjet e mia direkte nëse kishte filluar një procedurë të tillë dhe mbi ç'baza ligjore, Relatorja, jo vetëm nuk e rishikoi pozicionin e saj, por edhe gënjeu duke deklaruar se procedura kishte nisur me kërkesën time.*
 - c. *Relatorja, jo vetëm nuk ka përmbushur detyrën e saj për ndihmë dhe bashkëpunim, nuk ka respektuar pikën 2, të Vendimit Nr. 213, datë 18.06.2020 dhe Nr. 387, datë 07.10.2020, për të filluar një procedurë verifikimi të kriterit të pasurisë dhe figurës sipas Kreut IX, por ka nisur një procedurë tjetër jashtë kompetencave të saja, me qëllimin skualifikimin tim pa të drejtë nga procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke treguar qartazi arsye serioze njëanshmëri në zhvillimin e një procedurë, në kundërshtim të hapur dhe flagrant të dispozitave urdhëruese të KPA, sa i takon, kompetencës, procedurës së nxjerrjes së aktit (në këtë rast të anulimit apo shfuqizimit të aktit) formën e njoftimit të aktit sipas nenit 42.*
 - d. *Ky veprim i relatores, është miratuar edhe firmosur nga antarët e tjerë të Komisionit të Karrierës duke i bërë edhe ata njëloj, të njëanshëm në këtë procedurë.*
 - e. *Për sa më sipër, Relatorja ka anashkaluar në mënyrë flagrante, dispozitat proceduriale mbi kompetencën e saj, ka neglizhuar rëndë detyrat e ngarkuara nga ligji dhe organi epror KLGJ-ja për një periudhë 10 dhe 6 mujore për verifikimin e kriterit të figurës dhe pasurisë për kandidimin tim, ka nisur me iniciativën e saj jashtë kompetencave, një procedurë skualifikimi time me qëllim final shfuqizimin e pikës "2" të vendimeve Nr. 213, datë 18.06.2020 dhe Nr. 387, datë 07.10.2020 që e ngarkonte me detyrimin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, ndërsa antarët e tjerë të Komisionit, kanë neglizhuar rëndë detyrën e tyre për të diskutuar, verifikuar dhe vendosur mbi këtë çështje, duke firmosur dhe miratuar një procedurë të tillë. Këto veprime tregojnë dhe përbëjnë arsye serioze njëanshmërie në procedurën administrative në shqyrtimin dhe në procedurën administrative të ngritjes në detyrë dhe për rrjedhojë një pengesë ligjore për të marrë pjesë në këto procedura, sipas përcaktimeve të nenit 30 gërma "g", nenit 31/3 dhe 4 të KPAAdministrative dhe nenit 72 të Ligjit për Qeverisjen e Gjyqsorit, i cili përcakton se antarët që kanë pengesa ligjore nuk duhet të marrin pjesë në një procedurë.*
4. *Menjëherë me marrjen e kërkesës, në përputhje me detyrimin sipas nenit 76 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në respektim të përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni A, të Vendimit të tij Nr. 75, datë 23.05.2019, që parashikon se: "1. Pas caktimit me short, relatori i çështjes njofton kandidatin për fillimin e procedurës së verifikimit, duke i bërë të ditur të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtari të Këshillit. 2. Në rast se kandidati paraqet kërkesë për përjashtimin e*

relatorit të çështjes, Këshilli vendos jo më vonë se 3 ditë nga depozitimi i saj. ...”, është caktuar shqyrtimi i saj në mbledhjen plenare të Këshillit më datë 26.04.2021¹.

5. Në shqyrtimin e kësaj kërkesë nuk morrën pjesë anëtarët e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës për sa kohë kjo kërkesë kishte lidhje të drejtëpërdrejtë me to.
6. Në vlerësimin e kërkesës, Këshilli mbajti në konsideratë faktin se znj. {...} është palë në procedurë, ndërsa ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimeve nr. 85, nr. 86, dhe nr.87 datë 26.02.2020, ndërkohë që ky proces për znj. {...} është në fazën e verifikimit të plotësimit nga ajo të kushteve dhe kriterëve të kandidimit.
7. Fillimisht, në përputhje me nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit për kandidaten znj. {...}, si relator² është caktuar z. Alban Toro. Ndërkohë, pas pranimit nga Kryetari i Këshillit të kërkesës së relatorit për heqje dorë³ nga pjesëmarrja në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicion e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020, dhe pas shortit të hedhur, me Vendimin nr. 352, datë 24.09.2020, Këshilli vendosi të caktojë si relatores të procedurës së verifikimit ndaj kandidates znj. {...}, anëtarin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Marçela Shehu. Nga ana tjetër, me rënien e pengesës ligjore⁴ për të marrë pjesë në procedurat administrative ndaj kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicion e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020, z. Alban Toro, në përmbushje të detyrimit për të marrë pjesë në veprimtarinë e komisionit (neni 62 i Ligjit nr. 115/2016), anëtar i të cilit është, sikundër dhe në mbledhjet e Këshillit (neni 68 i Ligjit nr. 115/2016), është përfshirë përsëri në procedurat administrative ndaj kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për këtë pozicion të lirë.
8. Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja është njoftuar për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe për ndryshimin e relatorit. Konstatohet se nga ana e saj nuk ka shprehur asnjë kundërshtim sa i përket relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e Këshillit.

Vlerësimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor

9. Lidhur me kërkesën e znj. {...} për t’u dëgjuar në seancë plenare në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkesë, Këshilli duke analizuar legjislacionin në fuqi nuk konstaton mbartjen e një detyrimi të shprehur të organit publik për të dëgjuar një palë në rastet kur ajo paraqet kërkesa për përjashtim të anëtarit/ëve të organit publik nga pjesëmarrja në një procedurë e caktuar në të cilën ai/ajo merr pjesë.

¹ Datat 24 dhe 25 prill 2021 rezultojnë ditë pushimi.

² Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020.

³ Për shkak të kandidimit të bashkëshortes së tij.

⁴ Me Vendimin nr. 595, datë 26.11.2020, Këshilli ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për kandidaten znj. Elona Toro, për pozicionet e lira ku ka kandiduar, për shkak të tërheqjes nga kandidimi.

- 9.1 Në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative ndërsa parashikohet si detyrim i organit publik, të njoftojë palën lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, theksohet se ky detyrim është gjithmonë në ato raste kur jemi përpara marrjes së një vendimi përfundimtar dhe jo të një vendimi me karakter procedural, pra për një kërkesë për përjashtim të anëtarit/ëve të organit publik.
- 9.2 Gjithashtu në nenin 89 të KPrA parashikohet mundësia e organit publik për të mbyllur procedurën pa i dhënë të drejtën palës për t'u dëgjuar, ndër të tjera, edhe në rastin kur palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative.
- 9.3 Edhe Vendimi nr. 75 datë 23.05.2019, mbi të cilën bazohet kryesisht e gjithë procedura që ndjek Këshilli për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, përfshirë edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, përcakton komunikimin shkresor me kandidatin. Qartësisht në këtë vendim është parashikuar si mundësi dhe e drejtë e kandidatit *paraqitja e shpjegimeve me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.*
- 9.4 Për të gjithë sa më sipër, Këshilli bazuar në Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në KPrA, në vendimin e tij nr. 75 datë 23.05.20219, në kushtet kur kandidatja ka paraqitur pretendimet dhe shpjegimet e saj në formë shkresore, refuzoi kërkesën e saj për t'u dëgjuar në momentin e shqyrtimit të kërkesës për përjashtim të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.
10. Lidhur me kërkesën për përjashtimin e Relatores Marçela Shehu dhe dy antarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Z. Alban Toro dhe Z. Ilir Toska, nga shqyrtimi i procedurës dhe i çdo vendimarrjeje të ardhshme, duke analizuar pretendimet e znj. {...}, legjislacionin në fuqi dhe konkretisht Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative (KPrA), ashtu edhe Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019, Këshilli e gjen atë të pabazuar në ligj dhe në prova.
- 10.1 Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, përcakton rregulla të hollësishme të procesit që ndiqet nga organi publik, KLGJ, gjatë procedurës administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, ndër të tjera, edhe për emërimin gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Në këtë vendim janë përcaktuar edhe të drejtat dhe detyrimet që burojnë si për organin publik, ashtu dhe për kandidatët pjesëmarrës në procedurë. Vlen të përmendet se rregullimet sipas këtij akti nënligjor janë në përputhje dhe harmoni me ato të KPrA, me specifikime përkatëse sipas Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe veçantisë së procesit dhe organizimit të organit publik në këtë rast, KLGJ. Po ashtu, vlen të përmendet se në këtë procedurë administrative organi publik vepron përmes relatorit, që kujdeset për zhvillimin e procesit administrativ individual, kryhen hetimin administrativ dhe përgatit projektvendimet (neni 63 i Ligjit nr. 115/2016), komisionit përkatës, që kontrollon plotësinë e procedurave të ndjekura nga relatori përpara se çështja t'i kalojë për shqyrtim organit kolegjal (neni 62 i Ligjit nr. 115/2016), si dhe vetë këtij të

fundit, që është i vetmi organ vendimmarrës për themelin e çështjes (neni 61 i Ligjit nr. 115/2016).

- 10.2 Në nenin 76 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse edhe në nenin 31/3 të KPr.A, parashikohet e drejta e palës për të kërkuar përjashtimin e pjesëmarrjes së një anëtari të organit kolegjal nga një procedurë administrative, gjatë fazës paraprake apo deri në kohën e marrjes së vendimit. Kjo e drejtë ka gjetur pasqyrim edhe në Vendimin e Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, në të cilin janë parashikuar rregullime të metejshme të veçanta sa i përket shqyrtimit të një kërkesë të kësaj natyre, duke evidentuar njëkohësisht dhe referimin ligjor që përcakton shkaqet e përjashtimit, pikërisht në ligjin organik të Këshillit, konkretisht në nenin 75 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse kjo shprehimisht përcaktohet në nenin 76 të tij.
- 10.3 Këshilli konstaton se kandidatja znj.Hicka nuk ka ngritur asnjë kundërshtim në momentin e fillimit të procedurës së verifikimit, qoftë për relatorin e caktuar, ashtu dhe për ndonjë anëtar tjetër të tij.
- 10.4 Këshilli konstaton po ashtu se shkaqet për të cilat znj.{..} ka kërkuar përjashtimin e tre anëtarëve të tij, nuk bazohen në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 75 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, titulluar “*Heqja dorë*”, përcaktohet se: “*1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin ose komandimin e një gjyqtari dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një gjyqtari, si dhe nga çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një gjyqtari ose të funksionarëve të tjerë të sistemit gjyqësor, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli, në rastet e mëposhtme: a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën; b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij; c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet; ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor; d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit /bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor. ...”.*
- 10.5 Nga ana tjetër, Këshilli vlerëson si të pabazuar pretendimin e kandidates kërkuese të ngritur sipas shkronjës “g”, të nenit 30, të KPrA, sa kohë nuk rezulton dhe as referohet nga kandidatja ndonjë e dhënë sipas kërkesave të kësaj dispozite. Për anëtarët e Këshillit për të cilët është kërkuar përjashtimi, sikundër edhe për bashkëshortët ose të afërmit e tyre deri në shkallë të dytë, nuk konstatohen të jënë në marrëdhënie të tilla, me kandidaten kërkuese apo kandidatët e tjerë në procedurat respektive të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, mbi të

cilat të mund të vlerësohet për ekzistencën e arsyeve serioze për njëanshmëri me kandidaten në procedurën administrative në shqyrtim.

- 10.6 Këshilli çmon se pretendimet e kandidates kërkuese për ligjshmërinë e veprimeve procedurale të kryera nga relatorja e çështjes, nuk mund të përbëjnë shkak ligjor për përjashtimin e saj nga pjesëmarrja në procedurën administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të kërkueses ose edhe në çdo procedurë tjetër që lidhet me procedurat e ngritjes në detyrë ku ajo ka kandiduar. Këto pretendime janë pjesë e shqyrtimit të çështjes nga organi kolegjal, përpara të cilit çështja është parashtruar, ndërsa është vetëm ai, siç u theksua, organi vendimmarrës për themelin e çështjes.
- 10.7 Për të njëjtën arsye Këshilli vlerëson të pabazuara edhe pretendimet e kandidates kërkuese në drejtim të anëtarëve të tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, të cilët, sipas kërkueses, kanë miratuar veprimin e relatores për njoftimin e gjetjes së procedurës së verifikimit. Kompetenca e Komisionit në procedurën administrative të verifikimit është vetëm në kuadër të kontrollit të plotësisë së procedurës së ndjekur nga relatori i çështjes, me qëllimin e vetëm të përgatitjes sa më mirë të çështjes përpara kalimit për shqyrtim tek organi vendimmarrës, pra organi kolegjal. Është ky i fundit ai që vendos për çështjen, me propozim të relatorit ose të çdo anëtari të tij, duke qenë vendimi i tij një akt administrativ, i ankimueshëm sipas ligjit.
- 10.8 Këshilli çmon të pabazuar edhe pretendimin e kandidates kërkuese për njëanshmëri të ngritur, kryesisht ndaj z. Toro apo dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, duke evokuar trajtimin e një kërkese të saj mëparshme. Vlen të theksohet se rasti që znj. {...} i referohet lidhet me një vendimmarrje të Këshillit⁵, i cili, pas ankimit gjyqësor të saj, është gjetur i ligjshëm edhe nga gjykata⁶. Ndaj, Këshilli konsideron të papranueshëm pretendimet e kandidates kërkuese për njëanshmëri ndaj saj të disa prej anëtarëve, duke evokuar këtë vendimmarrje të tij.

Për këto arsye

Mbështetur në nenin 76 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni B, pika 3, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së kandidates znj. {...} për përjashtimin e znj. Marçela Shehu, në cilësinë e relatores dhe në çdo cilësi tjetër, në procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, të hapura me Vendimet nr. 85, nr. 86, nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁵ Vendimin nr. 67, datë 06.02.2020.

⁶ Vendimi nr. 12, datë 08.02.2021, i Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Refuzimin e kërkesës kandidates znj. {...} për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit z. Alban Toro dhe z. Ilir Toska, për të njëjtat procedura të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankim bashkë me vendimin përfundimtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Kryetare
NAUREDA LLAGAMI

Zëvendëskryetar
MAKSIM QOKU

Anëtar
MEDI BICI

Anëtare
BRIKENA UKPERAJ

Anëtare
FATMIRA LULI

Anëtare
BRUNILDA KADI

Anëtar
ERJON MUHARREMAJ

Anëtar
DRITAN HALLUNAJ